

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

FINCA Kosovo

31 DHJETOR 2019

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Menaxhmentin e FINCA Kosovë

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të FINCA Kosovë ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të hyrave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fondeve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me nenin 102, të Ligjit. Nr. 04 / L-093, të datës 12 Prill 2012, "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", siç është përshkruar në Shënimin 2 të pasqyrave financiare.

#### Baza për opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) dhe udhëzimin administrativ nr. 02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjorë dhe firmave të auditimit të lëshuara nga Këshilli i Kosovar për Raportimin Financiar të Republikës së Kosovës. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Auditorit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK)* që janë relevante në auditimin tonë të pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në përputhje me udhëzimin administrativ nr 02/2019 dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Çështjet kyçe të Auditimit

Çështjet kyçe të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Secila çështje kryesore dhe adresimi jonë respektiv janë përshkruar më poshtë.

Provizionimi për humbjet nga kreditë e klientëve	
<p>Huatë neto tek te klientët më 31 Dhjetor 2019 në vlerë prej 47,454,127 Euro (31 Dhjetor 2018: 41,024,578 Euro), duke përfshirë lejimet për provizionim të humbjeve nga huatë te klientëve në vlerë prej 1,318,801 Euro (31 Dhjetor 2018: 987,854 Euro).</p> <p>Ne i referohemi Shënimit 2 "Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit", Shënimi 4 "Vlerësimet Kontabël kritike dhe gjykimet" dhe Shënimi 7 "Huatë ndaj klientëve" për pasqyrat financiare japin informacion të detajuar mbi vlerësimin e provizionit për humbjet e kredive dhe paradhëniet e klientëve më 31 dhjetor 2019.</p>	
Çështje kyçe e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Ne jemi përqëndruar në këtë fushë sepse menaxhmenti ushtron gjykim të rëndësishëm, duke përdorur supozime subjektive, kur përcakton kohën dhe shumat e provizionit të humbjeve për kredi. Meqenëse huatë përbëjnë një pjesë të madhe të pasurive të Organizatës, dhe për shkak të rëndësisë së gjykimet të përdorur për vlerësimin e provizioneve individuale dhe kolektive, kjo konsiderohet të jetë një çështje kyçe e auditimit.</p> <p>Rregullorja e BQK-së për rrezikun kreditor kërkon që Organizata të njohë provizione të përgjithshme për portofolin e paklasifikuar (kategoria standarde dhe vrojtuese) bazuar në përvojën e dokumentuar historike të rregulluar për kushtet aktuale të tregut dhe perspektivës dhe për portofolin e klasifikuar rregullorja përcakton normat minimale të provizioneve, megjithatë Organizata duhet të sigurojë masa më të larta se minimumi rregullator nëse analiza e rrezikut të kreditor në ndonjë ekspozim specifik tregon një nevojë të tillë.</p>	<p>Përgjigja jonë e auditimit përfshin këto vijime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikimi i modelit dhe efektivitetit operativ të kontrolleve kryesore për procesin e monitorimit të performancës së kredisë</li> <li>• Metodologjia e rishikuar e provizionimit për të vendosur inputet kryesore të përdorura në llogaritjen e provizioneve dhe në bazë të mostrës u testuan inputet kryesore të përdorura.</li> <li>• Ne konkretisht kemi testuar përshtatshmërinë e normave "Roll Rates" të përdorura për të përcaktuar provizionin e humbjeve për portofolin e klasifikuar dhe jo të paklasifikuar, i cili përfshin një përmbledhje të metodologjisë së përdorur për ndërtimin e "Roll Rates" dhe një vlerësim nëse të dhënat e mbledhjeve historike që përdoren nga Menaxhmenti janë bazën e përshtatshme mbi të cilën parashikohen rikuperimet në të ardhmen në mjedisin aktual ekonomik.</li> <li>• Procedurat e kryera për të siguruar rehati në saktësinë e procesit të përlogaritjes së dëmtimit kolektiv përmes rillogaritjes së tarifës së provizionit bazuar në inputet e audituara.</li> <li>• Në bazë të mostrës kemi testuar kreditë që klasifikohen në përputhje me rregulloren e BQK-së për rrezikun e kredisë.</li> <li>• Vlerësuar shpalosjet e bëra në raport me rregullat përkatëse dhe standardet e kontabilitetit.</li> </ul>



Njohja e të ardhurave nga interesi në kredi dhe paradhëniet për klientët	
<p>Te ardhurat nga interesi dhe të ngjashme për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 ka një vlerë prej EUR 10,712,199 (31 Dhjetor 2018: 9,730,980 Euro).</p> <p>Ne i referohemi Shënimit 2 "Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit", Shënimi 7 "Huatë ndaj klientëve" dhe Shënimi 14 Të ardhurat nga interesi të përfshira në pasqyrat financiare ofrojnë informacion të detajuar mbi të ardhurat e interesit dhe normat efektive të interesit të kredive dhe paradhëniet për klientët.</p>	
Çështje kyçe e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Ne jemi përqendruar në këtë fushë kryesisht për shkak të madhësisë së këtij zëri të veçantë të pasqyrave financiare. Për më tepër, në raste të caktuara, norma e interesit efektiv të detyruar mund të mos korrespondojë me normën e interesit kontraktues të kredisë, e cila mund të sjellë një kompleksitet shtesë në llogaritje.</p> <p>Rrethanat e tilla lindin kur kushtet kontraktuale përfshijnë opsionet e parapagimit dhe kostot e tjera të transaksionit, të tilla si komisionet, zbritjet ose premiumet, të cilat Organizata i merr parasysh gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit.</p>	<p>Përgjigja jonë e auditimit përfshin këto vijime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ne kemi bërë rilogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza mujore. Të dhënat hyrëse, të tilla si shumat kryesore, normat e interesit kontraktual, valutat dhe datat e maturimit u testuan përmes testimit të detajeve dhe gjurmimit të dokumenteve burimore.</li> <li>• Në bazë të mostrës, ne kemi testuar tarifën e disbursimit dhe interesin e arkëtueshëm, përmes rilogaritjes dhe përputhshmërisë me dokumente mbështetëse siç janë marrëveshjet e huasë dhe planet e amortizimit.</li> </ul>

### Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 në pasqyrat financiare, i cili përshkruan bazën e kontabilitetit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për të ndihmuar Organizatën të jetë në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të nenit 102, të Ligjit Nr. 04 / L-093, datë 12 Prill 2012, "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobanka referuar më lart. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë i auditorit ka për qëllim informimin dhe përdorimin vetëm nga Organizat dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë tjetër përveç nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Organizatës më dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018, u audituan nga një auditor tjetër, i cili shprehu një opinion të pa-modifikuar për ato pasqyra më 15 Mars 2019.

Organizata përgatit një grup të veçantë të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, mbi të cilat ne lëshojmë një raport të veçantë të auditorit për menaxhmentin e FINCA Kosovë.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe e personave të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare.

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e nenit 102 të Ligjit Nr. 04/L-093 të datës 11 maj 2012 "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare" siç është përshkruar në shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë përshkak të mashtrimit apo gabimit.



Në pregaditjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për të vazhduar aktivitetin e sajë në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si dhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të biznesit, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

### Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në terësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit ose i gabimit dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit, planifikojmë dhe zbazojmë procedura përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve si dhe marrim evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme të për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, përshkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera si edhe shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e sajë. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri me datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Organizatës për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen dhe strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt mbi transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës, përveç qështje tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë cdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu iu deklarojmë personave të ngarkuar me qeverisjen e organizatës se ne jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që arsyeshëm mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë dhe, aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen e organizatës, ne përcaktojmë ato çështje që ishin kyçe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale prandaj edhe janë çështjet kyçe të auditimit. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

**Raport për Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore siç kërkohet nga udhëzimi administrativ nr. 02/2019**

Mbledhja e Bordit të FINCA Kosova na ka angazhuar më 22 korrik 2019 si auditorë të Organizatës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Ne konfirmojmë që:

- Opinioni ynë i auditimit për pasqyrat financiare i shprehur këtu është në përputhje me raportin shtesë dërguar komitetit të auditimit të Organizatës, të cilin e kemi lëshuar më 2 Prill 2020.
- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të përmendura në nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Organizata në kryerjen e auditimit.

*RSM Kosovo Sh.p.k.*

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtine, Republika e Kosovës

3 Prill 2020



Astrit Kelmendi

Partneri i Angazhimit


*Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjeje midis këtyre raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë*




FINCA Kosovo  
Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019 (në Euro)	Më 31 dhjetor 2018 (në Euro)
<b>ASETET</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	3,049,205	2,055,367
Huatë te klientët	7	47,454,127	41,024,578
Parapagimet dhe asetet e tjera	8	258,373	166,314
Pasuritë e paprekshme	9	12,821	8,031
Prona dhe pajisjet	10	1,782,429	182,020
<b>Gjithsej asetet</b>		<b>52,556,955</b>	<b>43,436,310</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Huazimet	11	36,087,909	32,158,237
Detyrimet tjera	12	950,997	896,952
Detyrimet e qerave	13	1,447,743	-
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>38,486,649</b>	<b>33,055,189</b>
<b>BALANCAT E FONDEVE</b>			
Kapitali i dhuruar	14	4,656,887	4,656,887
Te ardhurat (humbjet) e akumuluar		9,413,419	5,724,234
<b>Gjithsej balancat e fondeve</b>		<b>14,070,306</b>	<b>10,381,121</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe balancat e fondeve</b>		<b>52,556,955</b>	<b>43,436,310</b>

Këto pasqyra financiare janë të autorizuara për lëshim nga menaxhmenti i FINCA Kosova më 31 Mars 2020 dhe të nënshkuara në emër të tyre nga:

  
Ardian Kastrati  
Drejtor Ekzekutiv

  
Fisnik Kepuska  
Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese nga 6 deri 23 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

**FINCA Kosova**

**Pasqyra e tepricës ose e deficitit dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

Shënime		Për vitin që	Për vitin që
		përfundon më	përfundon më
		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
		(në Euro)	(në Euro)
Të hyrat nga interesi dhe të ngjashme	15	10,712,199	9,730,980
Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme	15	(2,095,657)	(2,007,385)
Neto të hyrat nga interesi		<b>8,616,542</b>	<b>7,723,595</b>
Provizionimi për humbjet nga kreditë	7	(797,810)	(680,909)
Interesi neto mbi të ardhura pas humbjeve nga provizionime të huave të klientëve		<b>7,818,732</b>	<b>7,042,686</b>
Të hyrat të tjera operative	16	513,346	494,571
Shpenzime për personelin	17	(2,141,758)	(2,040,983)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	18	(2,307,009)	(2,263,682)
Zhylerësimi dhe amortizimi	9,10	(316,018)	(50,829)
Rezultati nga transaksionet në kurset e këmbimit	19	(12,657)	(10,085)
Të ardhura të tjera jo-operative	20	134,549	(426)
<b>(Deficiti)/suficiti për vitin</b>		<b>3,689,185</b>	<b>3,171,252</b>
Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>3,689,185</b>	<b>3,171,252</b>

Shënimet shoqëruese nga 6 deri në 23 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.



**FINCA Kosovë**  
**Pasqyra e Bilancit të Fondeve**  
 Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

	<b>Kapitali i dhuruar</b>	<b>Të ardhurat (humbjet) e akumuluar</b>	<b>Gjithsej balanca e fondeve</b>
	(në Euro)	(në Euro)	(në Euro)
Gjendja më 1 janar 2018	4,656,887	2,552,982	7,209,869
Suficiti për vitin	-	3,171,555	3,171,555
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>4,656,887</b>	<b>5,724,234</b>	<b>10,381,121</b>
Suficiti për vitin	-	3,689,185	3,689,185
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>4,656,887</b>	<b>9,413,419</b>	<b>14,070,306</b>

Shënimet shoqëruese nga 6 deri në 23 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

**FINCA Kosovë**  
**Pasqyra e rrjedhës së pasrasë**  
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

Shënime	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 (në Euro)	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018 (në Euro)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Suficiti për vitin	3,689,185	3,171,252
<i>Rregullimet për vitin:</i>		
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	9,10 316,018	50,829
Humbja nga rënia në vlerë e huave	7 797,810	680,909
Të hyrat nga interesi	15 (10,712,199)	(9,730,980)
Shpenzimet e interesit	15 2,095,657	2,007,385
Neto të hyrat tjera jo operative	(134,549)	426
Këmbimi valuator	12,657	10,085
	<b>(3,935,421)</b>	<b>(3,810,094)</b>
Zvogëlimi i huas për klientët	7 (7,439,573)	(8,388,540)
Zvogëlimi në parapagime dhe asete tjera	8 92,060	32,682
Zvogëlimi / (Rritja) në të ardhurat e shtyra	7 144,385	59,035
Rritja në detyrimet tjera	12 (76,428)	183,024
Interesi i pranuar	10,673,930	9,661,729
Interesi i paguar	(2,106,026)	(2,068,784)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetin operacional</b>	<b>(2,647,073)</b>	<b>(4,330,948)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktiviteti investues</b>		
Blerja e pronës dhe pajisjeve	9 (289,487)	(115,434)
Blerja e aseteve të patrupëzuara	8 (9,644)	(8,260)
<b>Rrjedha e parasë e përdorur për aktivitetin e investimeve</b>	<b>(299,131)</b>	<b>(123,694)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar</b>		
Kreditë e marra nga huadhënësit	11 16,500,000	17,576,690
Kthimi i kredive dhe detyrimeve ndaj huadhënësve	11 (12,559,958)	(10,473,990)
<b>Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar</b>	<b>3,940,042</b>	<b>4,132,596</b>
Zvogëlimi neto në para të gatshme dhe ekuivalentët e parasë	993,838	(322,046)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë në fillim	2,055,367	2,377,413
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë në fund</b>	<b>3,049,205</b>	<b>2,055,367</b>
<b>6</b>		

Shënimet shoqëruese nga 6 deri në 23 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.